

AKT THEMELIMI
I
SHOQËRISË TREGTARE ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
"NOAH ENGINEERING" SH.P.K.

Kavaje, me 23.12.2024

Ortakët themelues:

- Arben Gjuzi vendlindja në Kavaje me nr. personal J009200651.
Bazuar në ligjin nr. 9901, datë 14.04.2008, "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" (i ndryshuar), ligjin nr. 9723, datë 03.05.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit" (i ndryshuar), sot më datë 23.12.2024 harton këtë Akt Themelimi të shoqërisë tregtare si më poshtë vijon:

NENI 1
Emri

1.1 Shoqëria tregtare mban emrin "NOAH ENGINEERING" SH.P.K.

1.2 Ndryshimi i emërimit të shoqërisë mund të bëhet vetëm me vendim të Ortakëve të Shoqërisë.

NENI 2
Forma

2.1 Shoqëria tregtare "NOAH ENGINEERING" SH.P.K. ka formën e një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar.

NENI 3
Zyra Qendrore

3.1 Shoqëria tregtare me përgjegjësi të kufizuar "NOAH ENGINEERING" SH.P.K. do të ketë zyrën e saj qendrore në adresën: Kavaje, Lagjia nr.3, rruga "Skuraj", objekt 4 - katesh, kati i pare, zona kadastrale nr. 8552, pasuria nr. 4/203.

NENI 4
Objekti i Veprimtarisë

4.1 Shoqëria do të ushtrojë veprimtarinë e saj tregtare si: konsulence inxhinierike ne fushen e ndertimit, konstruksione te ndryshme, import/eksport materialesh, nderitime dhe riparime ne objekte civile dhe publike.



NENI 5

Kohëzgjatja

5.1 Kohëzgjatja e aktivitetit të shoqërisë "NOAH ENGINEERING" SH.P.K. do të jetë me afat të pacaktuar.

NENI 6

Degët dhe Zyrat e Përfatësimit

6.1 Shoqëria tregtare "NOAH ENGINEERING" SH.P.K. mund të hapë degë të saj ose zyra përfatësimi brenda ose jashtë vendit.

NENI 7

Përgjegjësia e Ortakëve

7.1 Ortakët nuk përgjigjet për detyrimet e shoqërisë "NOAH ENGINEERING" SH.P.K. dhe mbulojnë personalisht humbjet e shoqërisë deri në pjesën e paslyer të kontributeve të nënshkruara prej tyre.

NENI 8

Kapitali i Regjistruar dhe Kuotat

8.1 Kapitali i regjistruar i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar "NOAH ENGINEERING" SH.P.K. është 100.000 (njëqindmije) lekë.

8.2 Ortakët e shoqërisë janë:

- 1- Z. Arben Gjuzi është zotëruar i 1 (një) kuote e cila përbën 100% të kapitalit të shoqërisë ose në vlerë 100.000 lekë.

NENI 9

Organet e Shoqërisë

Organet drejtuese të shoqërisë janë:

- Asambleja e Përgjithshme
- Administratori

Detyrat e organeve të shoqërisë do të përcaktohen në statutin e shoqërisë.

NENI 10

Administratori



Shoqëria administrohet nga një administrator që emërohet dhe shkarkohet nga Ortakë e Shoqërisë. Afati i emërimit është 5 (Pesë) vjet. Kompetencat e administratorit përcaktohen në statutin e shoqërisë.

Administrator i Shoqërisë është Z. Arben Gjuzi atësia Halli, lindur ne Kavaje, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar me numër personal J00920065L.

Ky Akt Themelimi përpilohet në 4 (katër) origjinale në gjuhën shqipe, të gjitha me të njëjtën vlerë ligjore.

ORTAKËT E SHOQËRISË

“NOAH ENGINEERING” SH.P.K.

Arben Gjuzi

